VENDIM
Nr.727, datë 1.11.2006

PËR SHKRIRJEN E DREJTORISË SË INFORMACIONIT AGROUSHQIMOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkrirjen e Drejtorisë së Informacionit Agroushqimor (Shtëpia e Propagandës Bujqësore), në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
2. Arkivi i filmit dhe atij dokumentar të depozitohen pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Dorëzimi dhe marrja në dorëzim e mjeteve, në përdorim të Drejtorisë së Informacionit Agroushqimor (DIA), në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të bëhen sipas bilancit kontabël në datën e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim. Afatet e dorëzimit dhe të marrjes në dorëzim caktohen me urdhër të Ministrit.
4. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
5. Shkronja "b" e pikës 2 të vendimit nr.28, datë 19.2.1970 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
6. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha